



Planuar / Dorezuar Punimje/Pratuto Received/Delivety	26-05-2023	3	viti god year
Organ/Njësia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	4484/2023		114



## Republika e Kosovës

### Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.633/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë me Kaltrina Avdullahi-Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.633/2023 të datës 13.04.2023 të parashtruar nga ankuesi me adresë:

kundër Vendimit me numër protokolli 0342/23 të datës 24.03.2023 të Mbikëqyrësit i drejtpërdrejtë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje”, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.05.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.633/2023 e datës 13.04.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet Vendimi me numër protokolli 0342/23 i datës 24.03.2023 i Udhëheqësit të Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për shqiptimin e masës disiplinore “Vërejtje” ndaj ankuesit.
- III. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e hequr masën disiplinore nga dosja e ankuesit në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendimi.

### A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i punësuar sipas Kontratës së Punës për Kohë të Pacaktuar të datës 16.07.2018 në pozitën “Mbikëqyrës i Lartë” në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në kuadër

të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë me datë 24.03.2023, ka nxjerrë Vendim me numër protokoll 0342/23 përmes të cilit i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje", me arsyetim për informim të gabuar në Qendrën Operative/Qendra e Paraburgimit në Prizren në lidhje me gjendjen numerike konkretisht me vendet e lira në pjesën banuese.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër protokoll 0342/2023 të datës 24.03.2023 të nxjerrë nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, me datë 13.04.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3522/2023 e regjistruar nën shenjë A.nr.633/2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 18.04.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës, ndërsa me datën 02.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka Administruar këto Prova:** Ankesë me numër protokoll 3522/2023 e datës 13.04.2023; Vendim me numër protokoll 0342/2023 i datës 24.03.2023; Kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore e datës 23.03.2023; Informatë me numër 339/23 e datës 16.03.2023 e protokolluar me datë 17.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër 3661/2023 e datës 18.04.2023; Përgjigje në ankesë me numër 539 e datës 02.05.2023; Kontratë pune për kohë të pacaktuar e datës 30.06.2023; Përshkrim i detyrave të punës; Dëshmi për hyrje dhe dalje e datës 15.03.2023; Formulari zyrtarë i informimit të ndërrimit me numër 333/23 i datës 15.03.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura në lëndë, të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit dhe mbi këtë bazë ka konstatuar se ankesa e ankuesit, *është e bazuar, sepse:*

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokoll 0342/23 të datës 24.03.2023 të Udhëheqësit të Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje", pretendon se masa disiplinore është e shqiptuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

Ndërsa lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, Kolegji konstaton se i njëjti ka deklaruar se me Vendimin me numër protokoll 0342/23 të datës 24.03.2023 të nxjerrë nga Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë i është shqiptuar masa disiplinore "Vrejtje" pa u sqaruar fare se si ka ndodhur deri te një keqkuptim i tillë, pasi që sipas pretendimeve të ankuesit ai ka raportuar për gjendjen aktuale dhe momentale, ndërsa pas raportimit gjegjësisht dorezimit të ndërrimit ku është dëshmuar edhe me "Formularin zyrtarë të informimit të ndërrimit" me numër 333/23 të datës 15.03.2023, ka ndryshuar gjendja me që rast janë liruara të paraburgosurit dhe janë krijuar vende të lira, për të cilat ankuesi nuk ka mundur ta di sepse ndërprerjen e paraburgimit e bënë Gjykata. Ndërsa në bazë të shkresës - informatës me numër protokoll 339/23 të datës 17.03.2023 i njëjti ka deklaruar se ka dhënë informacione të sakta për Qendrën Operative dhe se sipas tij lëshimet i ka bërë Qendra e Ndalimit si dhe ka pasur probleme të komunikimit me telefonin zyrtarë, andaj mbi këtë bazë ankuesi, kërkon që të anulohet Vendimi me numër protokoll 0342/23 i datës 24.03.2023 i nxjerrë nga

Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, sepse nuk ka prova që mund të dëshmohet se i njejtë ka bërë shkelje disiplinore.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe ligjshmërisë së Vendimit me numër protokolli 0342/23 të datës 24.03.2023 të Udhëheqësit të Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në dispozitivin të këtij vendimi është thirrur në dispozitat e nenit 59 pika 1.1 dhe nenit 58 pika 2.4 të Ligjit Nr. 08/L-131 për Shërbimin Korrektues të Kosovës, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, konstaton se me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë është përcaktuar se: *1.Nëpunësit profesional të shërbimit diplomatik dhe shërbimi korrektues janë nëpunës civilë me status të veçantë, të cilët rregullohen me këtë ligj dhe me ligj të veçantë...*" dhe si rrjedhojë konstatoi së nëpunësit e shërbimit korrektues kanë statusin e nëpunësve civilë me status të veçantë, respektivisht të njëjtit i nënshtrohen legjislacionit në fuqi për nëpunësit civilë si dhe ligjeve të veçanta lidhur me elementet e marrëdhënies së punës që kanë të bëjnë me: *1. kushte të veçanta apo shtesë për rekrutim; 2.2. të drejtat ose detyrimet specifike të tjera nga ato të parashikuara me këtë ligj; 2.3. rregullat e veçanta për zhvillimin e karrierës sipas sistemit të gradave; 2.4. zhvillimin profesional dhe nevojat për trajnime; 2.5. transferimin dhe sistematizimin e nëpunësve,* i rezultat i kësaj, për masat disiplinore që aplikohen ndaj nëpunësit profesional të shërbimit korrektues bazë për trajtimin e tyre është Ligji Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ndërsa në rastin konkret Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë nuk ka dhënë asnjë arsytim konkret se cilat dispozitat të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publikë i ka shkelur ankuesi me veprimet e tij, duke mos konstatuar drejtë elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".*

Kolegji i Këshillit, në bazë të vendimit të kontestuar me ankesë, konstaton se Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka marr për bazë dispozitat e nenit 50.paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: 1.1. shkaqet, rrethanat e kryerjes së shkeljes, rëndësinë dhe pasojat e saj; 1.2. shkallën e fajësisë; 1.3. ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji; 1.4. përprjekjet e mëparshme të nëpunësit për shumangien apo kufizimin e dëmit",* rrjedhimisht në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit Udhëheqësi i Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren në cilësinë e mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë ka dështuar të vërtetoj faktet nëse ankuesi me veprimet e tij nuk ka shkaktuar ndonjë dëm për institucionin apo palën tjetër, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 0342/23 i datës 24.03.2023 i Udhëheqësit të Sigurisë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren për shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" ndaj ankuesit, është në kundërshtim me nenin 45, 47, 48 dhe 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe i njëjti është i paligjshme në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të



Kosovës, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, janë të obliguar që bëjnë heqjen e masës disiplinore ndaj ankuesit nga dosja personale e tij sipas këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.633/2023*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

